



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST

Maj 2026

Nr. (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
30	06.05.2026	Kërkes për informacion në lidhje me: 1. A ka dijeni Ministria dhe AKZM për aktivitetet e raportuara në zonën Pishë-Poro-Nartë? 2. A janë kryer verifikime në terren nga strukturat tuaja? Nëse po, cilat janë konstatimet? 3. A rezulton që për këtë zonë të jetë dhënë ndonjë autorizim për ndërhyrje, rehabilitim rruge apo zhvillim tjetër? Nëse po, cili është ai?		Në proces		

		4. A është kjo ndërhyrje në përputhje me planin e menaxhimit të zonës së mbrojtur? 5. A janë respektuar procedurat për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe konsultimin publik? 6. A ka pasur ndryshime të fundit në kufijtë apo statusin e mbrojtjes së zonës që mundësojnë ndërhyrje të tilla? 7. Në rast se konstatohet shkelje, cilat janë masat që AKZM ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë? 8. Çfarë masash ka ndërmarrë ose parashikon të ndërmarrë Ministria për të garantuar mbrojtjen e Citizens.al promovon gazetarinë qytetare dhe fuqizimin e zërave të përgjegjshëm, në përputhje me vlerat e një shoqërie gjithëpranuese dhe tolerante, në respektim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. kësaj zone në përputhje me legjislacionin në fuqi				
31	11.05.2026	Kërkes për informacion në lidhje me: Informimit”: A ka nisur zyrtarisht zbatimi i projektit turistik në zonën e		Në proces		

Zvërnecit/Pishë Poro – Nartë?

Nëse po, mbi çfarë baze ligjore?

Ministri Sofjan Jaupaj deklaroi se kompania ka leje për ndërhyrjet në terren. A mund të na vihet në dispozicion:

- leja përkatëse;
- data e hyrjes në fuqi;
- dhe institucioni që e ka firmosur?

Si e shpjegon Ministria faktin që dokumenti i AZHT i paraqitur nga kompania përcakton se vendimi nuk ishte sigluar ende dhe kushtet nuk ishin plotësuar?

A konsiderohen ndërhyrjet e dokumentuara në terren — përfshirë shtrimin e rrugëve me zhavorr, përdorimin e ekskavatorëve dhe hapjen e aksesit — si “rrethim prone” apo si punime përgatitore ndërtimi?

A është kryer Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin në Zvërnec? Nëse po:

- kur është miratuar;
- nga cili institucion;
- dhe pse nuk është bërë publik?

Ministri deklaroi se në këtë kategori zone të mbrojtur

		ndërhyrjet lejohen pa VNM. Në cilin nen apo akt ligjor mbështetet ky interpretim? A ka kryer Ministria apo institucionet në varësi të saj inspektime në terren pas publikimit të pamjeve me makineri të rënda në zonën e mbrojtur? A konsideron Ministria se ndërhyrjet aktuale janë në përputhje me statusin e mbrojtur të Peizazhit Pishë Poro – Nartë?				
32	25.05.2026	Kërkes për informacion në lidhje me: A ka Ministria e Mjedisit informacion zyrtar mbi ndërhyrjet që po kryhen aktualisht në zonën e mbrojtur Pishë Poro–Nartë? Nëse po, ju lutem specifikoni natyrën e ndërhyrjeve të evidentuara. 2- Cili është subjekti/kompania që po kryen punimet apo ndërhyrjet në territorin e zonës së mbrojtur Pishë Poro–Nartë? Ju lutem vendosni në dispozicion emrin e plotë të subjektit, NIPTin dhe çdo informacion mbi kontraktimin apo autorizimin e tij. 3- A është pajisur ky subjekt me leje mjedisi, deklaratë mjedisore apo ndonjë autorizim tjetër për		Në proces		

kryerjen e punimeve në këtë zonë? Nëse po, ju lutem dërgoni kopje të dokumentacionit përkatës.

4- A është zhvilluar procedurë e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM/VNM paraprake) për këto ndërhyrje? Nëse po, cili ka qenë vendimi përfundimtar i Ministrisë apo i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit?

5- A ka kryer Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura apo Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit inspektime në terren lidhur me këtë rast? Nëse po, cilat kanë qenë gjetjet?

6- A janë konstatuar shkelje të legjislacionit mjedisor apo të legjislacionit për zonat e mbrojtura nga subjekti që po kryen ndërhyrjet? Nëse po, çfarë masash administrative apo ligjore janë marrë?

7- A ka kërkuar Ministria pezullimin e punimeve apo ndalimin e aktivitetit deri në verifikimin e plotë të situatës në terren?

		8- Duke qenë se zona e Pishë Poro–Nartë konsiderohet habitat me rëndësi të veçantë ekologjike, çfarë masash konkrete po merr Ministria për garantimin e mbrojtjes së integritetit ekologjik të saj?				
--	--	---	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.**
 - (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.**
 - (3) Identifikohet lloji i kërkesës.**
 - (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.**
- (Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)*
- (5) Ndiemon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.**
 - (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.**